

ALEKSNDRA GJONI  
ZYRE PERKTHIMI LIGJOR  
Selia : Rruga Durrësit Mbi Foto Kumi Kati 3 Zyra 6  
Cel: 068 21 52 014  
Kodi Fiskal 3907334 & NIPT K31518018 H Dega tatim Taksa Tirane

## KONTRATE PER SHITJE AKSIONESH

Ne Peania Attike ,sot me 5 Qershor 2006, midis

1- Shoqerise anonime me emertim "INTRACOM - SHOQERI ANONIME E KONSTRUKSIONIT TE VEPRAVE TEKNIKE DHE KONSTRUKSIONEVE METALIKE" dhe titull dallues "INTRAKAT", qe ndodhen ne Peania te Attikis, ne Km.19,5 te Rruges se Re Peania - Markopoulo, 190 02 Peania Attike ) me Kod Fiskal 094207780 te Deges tatim Taksa FABE Athine e perfaqesuar ligjerisht per nenshkrimin e kesaj Kontrate nga z. Petro K.Soureti, Drejtor i Pergjithshem (Keshilltar Drejtues) i saj ne baze te Proces Verbalit te dates 01.06.2006 te Keshillit Drejtues ( me poshte ne kete Kontrate "Shitesi" )  
dhe

2- Shoqerise Anonime me emertimin "INTRACOM S.A.- SHOQERI ANONIME E ZGJIDHJEVE TE TELEKOMUNIKACIONIT" dhe titull dallues "INTRACOM TELECOM" qe ndodhet ne Peania te Attikis, ne Km.19,5 te Rruges se Re Peania -Markopoulo, me Kod Fiskal 094157119 Dega Tatim Taksa FABE Athine e perfaqesuar ligjerisht nga z.Alexandro -Stergio N.Mano , Drejtor i Pergjithshem (Keshilltar Drejtues) i saj ne baze te Proces Verbalit te dates 02.06.2006 te Keshillit Drejtues ( me poshte ne kete Kontrate "Bleresi".)  
rane dakort dhe pranuan sa me poshte:

I) Shitesi ka ne zoterim te plote, pronesi dhe posedim 21.338 (njezete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete) aksione te zakonshme me vlere nominale 3.000 (tremije ) leke sejcila te shoqerise "INTRALBAN KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE " me titull dalues "INTRALBAN " Sh.a. me seli ne adresen : "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pallati "Sky Tower", kati 3-te, Tirane (e cila me poshte ne kete Kontrate do te quhet per shkurtim «Shoqeria») e cila eshte krijuar ligjerisht ne baze te Vendimit nr. 26143/2001 te Gjykates se Rrethit Tiran dhe me NIPT K 12006001 H. Aksionet e siperpermendura perfaqesojne 55% te kapitalit te pergjithshem aksioner te Shoqerise, i cili arrin me shumen prej 116.394.000 Leke i ndare ne 38.798 aksione te zakonshme nominale me vlere 3.000 (tremije ) Leke sejcili aksion.

II) Me kete Kontrate, Shitesi i shet , transferon dhe dorezon ne pronesi dhe posedim te plote Bleresit 21.338 (njezete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete) aksione nominale te Shoqerise kundrejt vleres totale prej



1.583.600 (nje milion peseqind e tridhjetete e tre e gjashteqind ) Euro, duke i premtuar dhe garantuar ato te ciluara nga cdo barre, borxh, takse, konfiskim, dorezani, sekuestrim, pretendim dhe te ciluara pergjithesisht nga cdo e mete ligjore ose/ dhe pretendim prej te treteve dhe cdo lloj e drejte te tyre . **Bleresi**, pasi mori parasysh garancite e dhena me siper nga **Shitesi** , blen sot 21.338 (njetete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete) aksione nominale te **Shoqerise** kundrejt shumes se rene dakord prej **1.583.600 (nje milion peseqind e treidhjetete e tre e gjashteqind ) Euro** te cilen e konsideron te drejte , te favorshme dhe qe i pergjigjet vleres aktuale te aksioneve dmth. 74,215 Euro per cdo aksion.


Te gjitha shumen e mesiperme te rene dakord **Bleresi** do t'ia paguaje **Shitesit** brenda 15 ( pesembedhjetete) diteve nga nenshkrimi i kesaj Kontrate.

**Shitesi** me nenshkrimin e kesaj Kontrate humbet te gjitha te drejta mbi keto 21.338 ( njetete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete ) aksione te zakonshme nominale te **Shoqerise** dhe njeh si pronar te vetem ekskluziv **Bleresin** , i cili qysh nga data e sotme ka te drejte t'i disponoje ato sipas deshires dhe si pronar me te drejta te plota.

**Bleresi** deklaroi se e pranon shitjen e 21.338 ( njetete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete) aksioneve nominale te zakonshme te **Shoqerise**, i merr ato ne dorezim dhe pronesi te plote qysh sot dhe deklaroi ne baze te garancive te dhena nga **Shitesi** nuk ka asnje pretendim ndaj **Shitesit** per sa siper.

Ne vazhdim palet rane dakord per sa me poshte:

1. **Shitesi** deklaroi se nuk ka dhe nuk mban asnje pretendim ndaj **Shoqerise** me cilesine e aksionerit te saj te derisotem dhe se heq dore shprehimisht dhe pa rezerva nga cdo pretendim i mundshem ndaj saj.
2. **Bleresi** nuk mban asnje pergjegjesi per cfaredo pretendimi te mundshem te **Shoqerise** ndaj **Shitesit** dhe qe rrjedh nga pronesia e deri me sotshme e ketij te fundit mbi 21.338 (njetete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete) aksionet nominale te zakonshme te **Shoqerise**.
3. Palet kontraktore marrin persiper te kryejne se bashku te gjitha veprimet e nevojshme ne baze te Statutit te **Shoqerise** dhe Ligjit Shqiptar , prane organeve kompetente Shiptare, lidhur me transferimin e 21.338 (njetete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete) aksioneve te zakonshme nominale te **Shoqerise** . Aktualisht **Shitesi** i jep **Shoqerise** dhe organeve kompetente porosine per te ktyer te gjitha veprimet e nevojshme per te cregjistruar **Shitesin** si pronar ekskluziv i 21.338 (njetete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete)



4. tete) aksioneve nominale te zakoneshme te Shoqerise dhe ne vend te tij te njihet si pronar i ligjshem dhe ekskluziv Bleresi.
5. Shkelja e cdonjerit prej kushteve te kesaj Kontrate, nga ana e paleve kontraktuese , i jep te drejten sejcilit prej tyre te pretendoje nga pergjegjesi, rehabilitimin e cdo demi qe rrjedh nga kjo shkelje.
6. Palet deklaruan se heqin dore ne menyre taksative dhe pa rezerva nga cdo e drejte e tyre per prishjen dhe hedhjen poshte te kesaj Kontrate per cdo shkak dhe arsye edhe per ndonje prej arsyeve qe parashikohen ne nenet 178,179 dhe 388 te Kodit Civil.
7. Cdo ndryshim i kushteve te kesaj Kontrate do te behet vetem me shkrim , duke perjashtuar cdo mjet tjeter, madje edhe me betim.
8. Per transferimin e 21.338 ( njezete e nje mije e treqind e tridhjetete e tete ) aksioneve te zakoneshme nominale te Shoqerise u paraqit nga Shitesi Deklarate e Transferimit nr. 8/05.06.2006 e Deges Tatim taksa Fabe ne baze te Ligjit 2238/94 si u ndryshua dhe eshte ne fuqi (Nr. fatures publikate 24589/5.06.2006)
9. Te gjitha mosmarreveshjet qe lindin ne lidhje me kete Kontrate do te zgjidhen sipas te Drejtes Greke dhe konkretisht nga Gjykatat kompetente te Athines.
9. Kjo Kontrate do te depozitohet nga palet prane Deges Tatim Taksa.

Per vertetimin e sa siper u hartua kjo Kontrate ne 4 (kater) kopje origjinale nga te cilat palet morren nga dy origjinale.

**PER SHITESIN**

Petros K. Souretis  
Drejtor i Pergjithshem  
-nenshkrimi, vula e INTRAKAT/

**P A L E T KONTRAKTUESE**

**PER BLERESIN**

Alexandros -Stergios N. Manos  
Drejtor i Pergjithshem  
-nenshkrimi, vula e INTRACOM TELECOM

**DEGA TATIM TAKSA FABE ATHINE**

NENI 79 Ligji 2238/94

Nr. Legalizimi 52

Athine, 05.06.2006

Per Degen Tatim Taksa

Emer, Mbiemer, Vula -

Vertetohet njesia me origjinalin

Athine , me 07.06.2006

Avokate Legalizuese Apostolou

Konstantina

Licence 19519 te Kolegjit te

Avokateve Athine

Gladstonos 20,P.Penteli

Tel: 210 6134370

- nenshkrimi, vula ,pulla-

**ALEKSANDRA M. BIONI**  
**PERKTHYESE LEGALE**  
CEL. 068 2152014

*[Signature]*